



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 4**  
Rrogozhinë, më 26.03.2024 ora 13 : 00<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.1138.Prot datë 20.03.2024, si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.02.2024.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit në Bashkinë Rrogozhinë”.  
*(Pikë e mbartur, shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse).*
- 6- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.  
*(Pikë e mbartur, shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse).*
- 7- Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.
- 8- Shqyrtim dhe diskutim me përfaqësues-in/it e projektit, “Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar” në Bashkinë Rrogozhinë, mbi ecurinë e punës dhe sfidat e hasura në zbatimin e këtij projekti përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023.
- 9- Të ndryshme.
  - Shqyrtim i informacionit dhe shprehjes së mendimit të ardhur nga Administratori i Njesisë Lekaj, mbi kërkesën e z. U. Bermeta banor i fshatit Zanbishë Njësia Administrative Lekaj për ndihmë financiare për shkak të dëmit të shkaktuar nga zjarri në fermën e tij.
  - Të tjera.



### **Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Silvana Aliu, Indrit Dedej, Merilin Saraçi, Besnike Coraj, Saimir Cani, Sokol Gosa, Mitat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Kalemi, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

### **Mungojnë :**

Shpati Kolgega, Lije Dedej, Hekuran Xhani, Fatbardha Sina.

### **Të ftuar :**

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
4. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vaditjes.
5. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
6. Luan Gjuzi - Përgjegjës i zyrës Juridike.
7. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
8. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
9. Xhensika Proshka - Përgjegjëse e Shërbimit Social.
10. Dorina Maçolli - Kordinatore e dhunës në familje
11. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.
12. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

### **Drejton mbledhjen :**

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 16- Këshilltarë.

## **HAPET MBLEDHJA**



**Mukades Gixhari** . Atëherë përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët : znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, znj. Merilin Saraçi, znj. Besnike Coraj, z. Saimir Cani, z. Sokol Gosa, z. Mitat Daja, z. Altin Tosku, znj. Gezime Met-hasani, z. Lulzim Hasa, znj. Alime Hoxha, z. Enver Memolla, znj. Fatmira Thartori, z. Renato Kalemi, z. Erind Tosku dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 16-Këshilltarë.

Lexojmë konfirmimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për Vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 27.02.2024.

Vendimi nr .7, datë 27.02.2024, “Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të z. Ferdi Avdiu”. Konfirmohet referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ky vendim t’i përcillet KQZ-së për procedura të mëtejshme.

Vendimi nr .8. datë 27.02.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”. Konfirmohet referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar .

Vendimi nr .9. datë 27.02.2024, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Konfirmohet Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Vendimi nr .10. datë 27.02.2024, “Për dhënien e ndihmës financiare të familjes së ish këshilltarit të ndjerë z. Bajazit Thaçi”. Konfirmohet në parim referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e këtij vendimi referojuni dispozitave në fuqi për përdorimin e fondit të veçantë si dhe parashikimeve të VKB-së të buxhetit të bashkisë tuaj për këtë fond.

Vendimi nr .11. datë 27.02.2024, “Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Merilin Saraçi”. Konfirmohet referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ,  
Prefekt, Afrim Qendro.

Të nderuar këshilltarë kemi një projektvendim shtesë, “Për dhënie ndihme financiare” prej 50 000 lekësh (pesëdhjetëmijë) z. Fatbardh Sokoli të cilin e gjeni të fotokopjuar secili përpara. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës këtë projektvendim dhe ta shqyrtojmë në vijim? E hedhim në votim? Të gjithë pro dhe vota ime pro. Miratohet.

*-Miratohet me 16-vota pro, përfshirja në rendi e ditës së projektvendimit, “Për dhënie ndihme financiare” prej 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekësh z. Fatbardh Sokoli.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.



*-Miratohet me 16-vota pro, pika 1 (një) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 2, Miratim i procesverbalit Nr.3, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.02.2024. Jeni dakord me këtë pikë të rendit të ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 16-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Fjala për z. Ledian Hasani përgjegjës i shërbimit social.

**Ledian Hasani** . Në total janë 20 familje që janë përfitueseme një fond prej 72 mijë lekësh të reja.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje në lidhje me këtë pikë për z. Ledian? E hedhim në votim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 16-vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .12.** Miratohet me 16-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1080.Prot datë 13.03.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% ”.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën katër të rendit të ditës, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton përgjegjësi i zyrës së Shërbimit Social z. Ledian Hasani.

**Ledian Hasani** . Kemi në total 23 familje me një fond prej 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë diskutim për këtë pikë?

**Ledian Hasani** . Nuk ka lidhje me numrin e familjarëve kryefamiljari përfiton 18 mijë lek, një i rritur mbi 18 vjeç përfiton 12 mijë e 600 lekë, kurse kush është poshtë 18 vjeçëve përfiton 9 mijë lekë të vjetra këto mblidhen por jo të gjithë përfitojnë nga 9 mijë lekë vetëm kryefamiljari. Do bëjmë një ngritje të vogël muajin tjetër nga 18 mijë mund të shkojë 21 mijë. Këto janë nga Bashkia.



**Mukades Gixhari** . Faleminderit z. Ledian. Pyetje tjetër? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 16-vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .13.** Miratohet me 16-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1123.Prot datë 19.03.2024,“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i pushtetit vendor“.

**Mukades Gixhari** . Vazhdojmë me pikën 5- së, Miratim i projekt-vendimit, “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit në Bashkinë Rrogozhinë”. Fjala për anëtarin e këshillit bashkiak, njëkohësisht kryetar i komisionit arsim kulturë z. Sokol Gosa. Përshëndetje z. Sokol fjala për ju.

**Sokol Gosa** . Edhe mbledhjen tjetër diskutuam për ngritjen e këtij komisioni ku për arsye objektive mungesën e të ndjerit Bashkim Kushi që u nda nga jeta kemi menduar që të propozojmë: Xhavit Halili, Bardhyl Tosku dhe Naim Tafxhafa. Mendoj që janë figura të cilët i kanë dhënë qytetit tonë kanë kontribuar në fusha të ndryshme dhe mendoj se dhe mendimi i tyre për miratimin apo këshillimin për propozimet që do të vijnë për vlerësimin e figurave të ndryshme të qytetit tonë do të jetë i vlefshëm dhe do ti shërbejë shumë punës së këtij komisioni ky është mendimi im për ngritjen e këtij komisioni tani dhe nga anëtarët e këshillit. Është edhe 1 që tha dhe Visi , po Luani është Luan Gjuzi.

**Enver Memolla** . Unë i dëgjova me vëmendje emrat dhe përpara se të kalojmë tek miratimi i emrave unë dua që edhe në emër të grupit të PS apo dhe për kolegun Indriti ndoshta flet më vonë përpara se të krijohet komisioni me emrat konkretë të bëjmë një takim një mbledhje me kryetarët e grupeve të partive dhe oastaj të diskutohet me funksionin që do kenë në këshill bashkiak. Nuk mendoj se është direkt për sot propozim për t’u bërë me miratim në këshill bashkiak këtë mendoj.

**Sokol Gosa** . Unë i kam kontaktuar ato.

**Enver Memolla** . Unë nuk kam gjë me emrat thjeshtë të ulemi dhe të përcaktojmë kush janë kryetar .

**Sokol Gosa** . Ka dy tre muaj kjo, vetëm ishte rasti i të ndjerit Bashkim që gjeta një emër tjetër.



**Enver Memolla** . Ta caktonim që të vinim këtu e të thonim kryetar filani anëtar filani ishin dy gjëra që duhej të ndaheshin.

**Sokol Gosa** . Mendova që ishin diskutuar këtu dhe diheshin pak a shumëprandaj.

**Enver Memolla** . Nuk e di kolegët...?

**Alime Hoxha** . Shqyrtimi paraprak që kërkon Veri është për përcaktimin e pozicionit të secilit.

**Mitat Daja** . Edhe unë mendoj si Veri se ndonjëherë ndodhin inate personale dhe ngel procesi ose nuk kam lidhje fare me emrat këto janë kryetarë grupesh mund të them dhe unë një emër se dhe unë kam... Meqë këto janë grupe të mëdha të konsultohen këto mirë është para se të vendoset për emrat se tani duket sikur kemi ndonjë gjë...

**Enver Memolla** . Jo për emrat nuk ka lidhje me emrat.

**Mitat Daja** . Atëherë që në Dhjetor është marrë një propozim për shpalljen qytetar nderi të një personi që është bërë një kërkesë, ka që në Dhjetor, Janar, Shkurt dhe sot jemi Mars dhe akoma nuk është bërë sepse duhen dhe njerëz që duan ta bëjnë këtë punë ndoshta nuk duan ta bëjnë këtë punë ose të flasim me njerëzit Veri t'i thotë që do mblidhesh se do ketë emra të ndryshëm. Jo këtu nuk e dua se nuk më pëlqen mua këtu nuk e dua.

**Enver Memolla** . Ka një llogjikë gjëja e thashë nëse do ishte komunikuar me mua dhe Indritin të kishim diskutuar jo për emrat thjeshtë po këto janë tre emra ta zgjedhim pjesën e pozicioneve që do kenë sepse nesër ne po cedojmë anëtarët e këshillit tek komisionet dhe një titull nderi të ngel në dorë pastaj. Ato janë njerëz të vlerësuar e dimë shumë mirë kush janë, ka dhe të tjerë por këto tre që tha Sokoli nuk kam gjë me emrat...

**Sokol Gosa** . Ku qëndron problemi këtu Vero? Ne kemi 4 muaj, biles që u shty ti e di shumë mirë, tani unë mendoj që kalon në Këshill çdo gjë ...

**Enver Memolla** . Kë do vesh kryetar komisioni?

**Sokol Gosa** . E caktojmë sot.

**Enver Memolla** . Këtë po them.



**Sokol Gosa** . Unë jam marrë me këtë pjesë kam 4 muaj ti më thua sot kështu nuk kuptoj!

**Enver Memolla** . A ke folur me gjithësecilin?

**Sokol Gosa** . Me gjithësecilin.

**Enver Memolla** . Kujt ja ke lënë pozicionin e kryetarit?

**Sokol Gosa** . Për vete unë do e mbaj.

**Enver Memolla** . Po nuk e merr se je anëtar këshilli.

**Sokol Gosa** . Po mirë do parë mirë si funksionon.

**Enver Memolla** . Nuk e merr dot prandaj...

**Sokol Gosa** . Duhet parë juristi duhet të ishte këtu të shikohej...Po më parë ka pasur komision të tillë Viso? Nuk hyn politika fare këtu nuk ka lidhje politika.

**Enver Memolla** . Nga ana juridike Sokoli mund të jetë kryetar komisioni?

**Ervis Shera** . Së pari duhet të ketë vullnet mes palëve.

**Enver Memolla** . Unë këtë po them.

**Mukades Gixhari** . Të zgjidhet ky problem me z. Sokol dhe kryetarët e grupeve.

**Sokol Gosa** . Sot mendoja për ngritjen e komisionit prandaj quhet këshillimor nuk vendosim ne, ne i propozojmë këshillit janë këto emra një, dy, tre do jemi ne pastaj që vendosim.

**Mukades Gixhari** . Me dy kryetarët e grupeve zgjedheni. Vazhdojmë me pikën 6-të, “Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”. Fjala për drejtorin e bujqësisë z. Elton Xhani. Përshëndetje z. Elton fjala për ju.

**Elton Xhani** . Përshëndetje të gjithëve! Nuk e di është e nevojshme që ta përsëris relativimin sërish se ka qenë dhe Arturi herën e kaluar mbi punën e bërë në sitimin kullues në periudhën



Janar-Dhjetor të 2023. Është punuar në sistemin e riparimit të kanleve vaditëse dhe kulluese në hapjen e kanleve të dyta të treta në të gjithë territorin e bashkisë dhe të njësive administrative. Po kështu kemi riparuar kalimin e kanleve nga një parcelë në tjetrën në anë të rrugës me tombino ose tuba që janë riparuar buzë kanleve. Përsa i përket kanalit vaditës duke marrë shkas dhe nga ankesat e shumta të fermerëve të Rrogozhinës dhe Njësive Administrative është bërë dërgimi i shkresave të shumta drejt Bordit të Kullimit shkak është dhe ndërtimi me beton i kanalit vaditës. Pak më parë isha dhe me drejtorin e bordit për pjesën e Rrogozhinës tek pjesa e lagjes së burgut është kërkuar riparimi në atë territor. Ka mbaruar pjesa tek burgu do bëhet pjesa që lidhet nga kasapi deri tek burgu. Gjatë 2023 janë pastruar 2.5 km kanal vaditës nga zona pas burgut në drejtim të autostradës dhe me numër kadastral 3235. Ajo zona e pas burgut është thuajse e përfunduar e gjitha vetëm një pjesë e vogël e kanalit vaditës nuk është përfunduar kemi plan me skrepin që tani ne kemi që nuk është krahgjatë por është skrep i vogël ta plotësojmë të gjithë. Atë mjet kemi ku ta çoj më përpara ta çoj për rregullim rrugësh për rregullim kanalesh po mundohemi që t'i bëjmë të gjitha nga pak. Është pastruar 1 km kanal vaditës në fshatin Harizaj të Njesisë Administrative Lekaj është pastruar 1.2 km kanal vaditës në fshatin Gërmej dhe 1 km kanal vaditës pranë rezervuarit të lagjes së Bicerrve nuk e di kush është i zonës e di ku është pastruar. Tani unë kam shkuar vetë në vend dhe e kam matur me informacionin që i kam kërkuar drejtorit të mëparshëm të bujqësisë që ka qenë aty Andit, kam qenë dhe vetë në vend që e kam parë pjesën e ...tani unë 4 muaj nuk i kam mbushur 5 muaj në drejtorinë e bujqësisë dhe këto evidenca që i kam marrë i kam marrë diku. Tani lojëra fjalësh nuk do bëjmë unë po them ato që janë pastruar nëse doni mund të shkojmë dhe bashkë të shikojmë. Pjesë e komisionit bëhem dhe unë nëse doni ska gjë shkojmë me makinën time nuk është problem. Është pastruar kanali K5 në zonën e Gosës nga bordi i kullimit në bazë të ankesave që ne kemi bërë dhe kemi shkuar, kemi në plan të pastrojmë për muajin Mars dhe Prill të gjithë kanalet vaditës në zonën e njësisë administrative Lekaj jo të gjitha se u shpreha gabim por në numër të konsiderueshëm kilometrash. Tani janë pastruar 300-400 ml në zonën e Spillesë në fshatin Ballaj në fshatin Vilë këto kanë qenë për 2023, tani për 2024 do vazhdojë puna që...Kanali që kalon mepërmes Rrogozhinës ta shpjegoj unë është bërë me beton tek lagjja e "Shimëve" është bërë me beton këtu tek lagjja e "Burgut" do bëhet dhe pastrimi i kanalit nga lugu që është këtu tek Burgu deri tek ura e trenit tek kasapi. Kanali Peqin-Kavajë do pastrohet i gjithi po ne po tentojmë është duke u pastruar tek lagjja e Shimëve pak më këtej është duke u bërë po hidhet beton atje. Do pastrohet i gjithi deri në Njësinë Lekaj por ne po tentojmë pjesën ku ka familje ku ka problematika të mëdha ku ka thithje uji që mund të shkaktojë edhe dëme nesër pasnesër ne po tentojmë që t'i bëjmë me beton. Tokat djerr në bashkinë Rrogozhinë janë shumë të pakta sepse edhe po nuk e punova unë do e marri dikush tjetër me qera që e punon, por synimi është aty ku punohet të pastrohet më shumë. Zona e Gosës është prekur më shumë nga bordi i kullimit nga ne si bashki do preket tani dhe Njësia Lekaj është problematikë që...





**Altin Tosku** . Duhet të vini me një videoprojektor në prezantim.

**Elton Xhani** . Është shumë e drejtë në vazhdim...ne nuk kemi hedhur asnjë foto në rrjete sociale për pastrimin e kanaleve.Skrepit që ne kemi nuk po pushon duke rregulluar rrugët se e di shumë mirë problemet që ne kemi. Mua më vjen shumë mirë që ti e ngre si problem këtu që dhe unë ta di dhe shkojmë bashkë e shohim t'i japim zgjidhje. Përroi që është tek Shimtë mundësisht nesër mund të shkojë skrepi për pastrim, tani nuk do çojmë punëtorë me lopatë me pastruar kanalën. Në qoftë se e ke kështu shkojmë bashkë dhe e shohim atë përroin ku e keni...

**Altin Tosku** . Besoj se e di.

**Elton Xhani** . Unë e kam parë them se do i jap zgjidhje shumë shpejt pjesës së përroit.Tani ajo pjesa e përroit atje do skrep krahëgjatë nuk është se po e kemi ne dhe nuk po duam me e bërë, skrepi që është nuk e mundëson dot.

**Enver Memolla** . Në mos gaboj vjet në këtë kohë ka qenë nga Prilli nga Maji u çua kanali i madh Peqin Kavajë ai përroi i Shimve bëri hatanë aty unë nuk e di si do zgjidhet, këtu ka dalë dhe ai muhabeti qafëgjatë, qafëshkurtër por kanë humbur të dy... unë nuk e di pse e ke lënë pas dore. Ai përroja është rrezik dhe për banesat, tani e ka fajin populli që ka hyrë në kanal apo kanali zgjidheni me polici bashkiake. Ka mudnësi që ai ka taposur kanalën e zogut ka dy ditë pa u zhbllokuar. A e di se sa parcela tokë rrezikohen, që dalin jashtë funksionimit? Dhe ti e di kush është arsyeja apo jo? Atje jo pak por tre parcela marrin fund nëse ndodh para kanalit të madh nuk hapet, ndoshta nuk hapet ajo vija e zogut që derdhet direkt në Shkumbin, keni kanalën e tretë që ka funksionuar në vite tek kjo pjesë. Të paktën nëse nuk keni krahëgjatë iku ai fond u dogj por merrni masat para kohe, sepse realisht do degradojë të treja blloqet e tokave do keni punë ju pastaj. Po flas prandaj thashë që kam mesazhet këtu janë dy fermerë që kanë mbjellë shegë dhe ftonj dhe është gjynah që nga papërgjegjshmëria juaj do e them troç fare këtë pjesë, se po erdhi kanali dhe të mbytet ai përroja fajet ngelin tek ty dhe ti e di shumë mirë në sektorin e bujqësisë çfarë ndodh me këtë lloj vaji me këtë lloj acideti kur thanë kallamin pjesën tjetër e id vetë çfarë i bën. Bëhet fjalë për 435 ml i ke në hartë merrni masa të paktën të bëni këtë se kanali i zogut do krahëgjatë, ai përroi i Shimve është problem më vete. Po them jo kanali i zogut se nuk ke mundësi ta bësh me atë skrep që ke e di shumë mirë se kam folur dhe me kryetarin, çoni skrepin e vogël që keni me zinxhirë dhe hapni atë pjesën e kanalit të tretë që thoni ju në gjuhën tuaj që ta bëjë ky derdhjen, se realisht të thashë ke tre blloqe janë gati 500 ha dhe zotëria e ka mbjellë tre herë shegën ta mbjelli dhe këtë vit ai, falimentoj, prandaj po them po të dush ta sjell fermerin në zyrë takoje fol. Bëhet fjalë 430 ml dhe 200 m rrugë një bllok që është prishur.



**Mukades Gixhari** . Ndonjë gjë tjetër? Atëherë ta falenderojmë z. Elton.

**Enver Memolla** . Tani kisha diçka në lidhje me projektvendimin e mëparshëm se fola dhe me Visin për anën ligjore fola dhe me Sokolin dhe realisht ngaqë është komisioni parë që bëhet ligjërisht në marrim propozimet të mirëqëna dhe vetë komisioni i përbërë nga pesë anëtarë ta zgjedhi vetë kryetarin e komisionit për këtë pjesë, duke qenë se është komision që ngrihet për herë të parë. Dakord z. Indrit?

**Mukades Gixhari** . z. Xhavit Halili, z. Sokol Gosa, z. Bardhyl Tosku, z. Naim Tafxhafa dhe z. Luan Gjuzi. Kështu z. Sokol?

**Enver Memolla** . Me Luanin është folur? Në rregull Sokol?

**Sokol Gosa** . Në rregull.

**Enver Memolla** . Ok.

**Mukades Gixhari** . Atëherë e hedhim në votim komisionin? Pro kundër abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 16-vota pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.*

**Vendim nr .14**. Miratohet me 16-vota pro projektvendimi i propozuar nga Këshilltarët dhe Kryetarja e Këshillit, me shkresë Nr.773.Prot datë 20.02.2024 “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për Bashkinë Rrogozhinë“, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.773/1.Prot datë 20.02.2024.

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën 7-të, të rendit të ditës, Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”. Fjala për Koordinatorën vendore të dhunës në familje znj. Dorina Maçolli.

**Dorina Maçolli** . Përsëndetje të gjithëve! Në radhë të parë ju falderoj që më keni thirrur për të ju dhënë informacion për dhunën në familje dhe barazinë gjinore. Të ju bëj një prezantim unë drejtoj mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës me një marrëveshje prej 11 institucioneve si gjykatë, prokurori, përmbarrim, zyrë pune, polici, arsim, shëndetësi etj mjekësi ligjore. Kemi një bashkëpunim shumë të mirë ndër-institucional për menaxhimin e rastit unë jam ajo që kontrollon a është menaxhuar ky rast dhe a është dhënë ndihma e duhur nga këto institucione. Gjithashtu



disa nga masat që unë kam marrë për 2024 edhe për 2023 kanë qenë fushatat e gjëra sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me gra dhe vajza me nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve jo vetëm të bashkisë Rrogozhinë por edhe të njërive të saj. Gjatë vitit 2023 kam pasur 23 raste, 16 me urdhër mbrojtje këto 16 gra paguhen dhe marrin një pagesë prej 100 mijë lekësh të vjetra, si dëmshpërblim për dhunën që kanë pasur. Gjithashtu kam një bashkëpunim shumë të mirë dhe me organizata joqeveritare të cilat japin ndihmesë sipas rastit dhe nevojave që kanë me paketa ushqimore me bonuse qeraje etj. Në qoftë se keni ndonjë pyetje ose informim që doni ju mund të më pyesni.

**Indrit Dedej .** Keni raste dhune në momnetin aktual?

**Dorina Maçolli .** Po gjatë muajit Janar kemi 10 raste, ndërsa në Shkurt 8 raste , 18 raste gjithsej ky është një vend që bazohet nga një mentalitet patriarkal , se është viti i 6 që unë jam kordinatore dhune më vjen shumë keq për këtë por vazhdojmë me fushata sensibilizuese , ndërgjegjësuese, këshilluese. Atëherë në 2021 dhe 2022 kemi pasur mbi 40 raste në vit.

**Alime Hoxha .** Fondi i urdhërit të mbrojtjes mundësohet nga Bashkia?

**Dorina Maçolli .** Jo nga shteti. Në mometin që gjykata vendos që dhunuesi të largohet nga banesa urdhëron kordinatorin e dhunës dhe policinë të nxjerrë dhunuesin nga banesa, kemi pasur raste dhe me problematika të shëndetit mendor i kemi dhënë një zgjidhje duke bashkëpunuar me organizata joqeveritare kemi larguar të dhunuarën bashkë me fëmijët në një vend tjetër në banesë me qera gjithashtu i kemi gjetur dhe punë në bashkëpunim me zyrën e punës, paketa ushqimore sa të rimëkëmbet po ashtu dhe ndihmë ligjore dhe psikologjike.

**Alime Hoxha .** Po personat që dhunojnë?

**Dorina Maçolli .** Personat që janë dhunues kanë një zgjidhje tjetër, ka një projekt tjetër që të trajtohen me psikolog të specializuar . Vetëm dy raste kam që kanë pranuar dhe kanë kthyer faqen dhe realisht është përmirësuar familja. I këshillojmë por është pak mentaliteti që nuk e pranojnë që kanë nevojë për psikolog është pak e vështirë kjo pjesë.

**Indrit Dedej .** Rasti që ndodhi në Gosë në fshatin Vilë që fëmija vrau nënën ?

**Dorina Maçolli .** Ai ka qenë me probleme të shëndetit mendor ka qenë i shtruar në psikiatri policia ka vajtur disa herë për të folur me nënën në qoftë se do të bëjë një denoncim dhe nëna nuk ka pranuar asnjëherë po ashtu dhe kryetarja e njësisë por nëna nuk ka pranuar asnjëherë që ta



denoncojë dhe në momentin dikush nuk denoncon ne nuk mund të marrim masa se në fund unë zbatoj vendimin e gjykatës dhe vazhdoj monitorimin e rastit.

**Indrit Dedej** . Ai është problematik me lënë në dëshirën e tij, do ta denoncosh apo jo... institucioni ta katapultojnë dhe ta çojnë tek 5.

**Dorina Maçolli** . Është bërë kërkesa disa herë nga policia. Për momentin ne hasim një problem shumë të madh me personat e shëndetit mendor shoh që psikiatritë nuk kanë më vend janë tejmbushur dhe unë kam pasur një problem real që gjykata thotë : Vendim, ky dhunues të shkojë të shtrohet në psikiatri, çfarë ndidh kur e çoj me polici atje? Psikiatria i jep një mjekim ta njerr tek dera dhe thotë çoje ku të duash me një mjekim të detyruar, ka burg është Shënkolli ka qenë Zaharia por problemi është që unë zbatoj vendimin e gjykatës. Kur gjykata thotë ta çoj në psikiatri do e çoj atje nuk mund ta çoj unë në burg.

**Indrit Dedej** . Rasti që ka ndodhur atje është zero puna e policisë për mua.

**Dorina Maçolli** . Policia disa herë mesa jam unë në dijeni ka bërë kërkesë që zotëria të shtrohet në psikiatri dhe nuk i është marrë për bazë mesa kam folur unë me OPGJ-në e Kavajës. Shumicën i kemi në punë por çfarë ndodh janë konsumues të alkolit shkojnë në darkë dhe dhunojnë bashkëshorten/fëmijët nuk vjen vetëm nga papunësia.

**Silvana Aliu** . Një pyetje për drejtorin e financës së bashkisë. A jemi në gjendje të marrim me qera dy apartamente sepse dhunuesin nuk kemi ku ta çojmë nuk mund ta kthejmë sërish në shtëpi. A mund të marrim dy banesa me qera që të jenë në dispozicion.

**Rezart Vogli** . Ne mund ta marrim me qera por a lejon gjykata.

**Dorina Maçolli** . Për mendimin tim këto duhen për rastet që janë në rrezik për jetën. Në momentin që ne do kishim një strehëz apo një godinë multifunksionale do ta conim...

**Erind Tosku** . Po shkollat që dalin jashtë funksionit nga ulja e numrit të nxënësve mund të kthehen në qendër të tillë. Pra a mund t'i certifikojmë si qendra sociale këto shkolla?

**Dorina Maçolli** . Do ishte mirë përgjegjësja bashkë me drejtorin të bënin projekte për këtë qëllim.

**Sokol Gosa** . Kush janë shkaqet? Ne si Bashki si komunitet nuk jemi dalluar për këto fenomene



së fundmi po dalin pra mentaliteti nuk është kaq... Alkoli përdoruesit sa është përqindja se ato dihet kush janë? Rezultate a ke pasur, sa kanë ndryshuar me përqindje? Dhe fundit po më tepër çfarë mund të bëni?

**Enver Memolla** . Thatë që janë 18 raste. Ka nga këto raste të përsëritura?

**Dorina Maçolli** . Po.

**Enver Memolla** . Çfarë masash po merren për këto?

**Dorina Maçolli** . Unë zbatoj vendimin e gjykatës.

**Enver Memolla** . Ripërsëritës ka të dënuar?

**Dorina Maçolli** . Po kemi një.

**Enver Memolla** . Burgu i Shën Kollit?

**Dorina Maçolli** . Jo është në Peqin.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë pyetje tjetër? Faleminderit Dorina. Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtim dhe diskutim me përfaqësues-in/it e projektit, “Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar” në Bashkinë Rrogozhinë, mbi ecurinë e punës dhe sfidat e hasura në zbatimin e këtij projekti përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023.

Ju bëj me dije që me datë 21.03.2024 një komision i përbërë prej tre këshilltarësh sipas miratimit të këshillit në mbledhjen e datës 27.02.2024, kanë verifikuar në vend punën dhe zbatimin e projektit “Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijë me aftësi të kufizuar”. Kush e do fjalën së pari nga Këshilltarët pjesë të këtij Komisioni? Po znj. Silvana.

**Silvana Aliu** . Atëherë i kërkoj kolegëve duke qenë se nga komisioni hetimor që bëmë atë ditë dhe i lamë disa detyra dhe i kemi kërkuar që për 2-3 muaj të bëjmë një verifikim tjetër dhe rezultatet t’i japim në një mbledhje tjetër. Kemi lënë disa detyra.

**Enver Memolla** . Kërkoj që nga dy anëtarë ky komision të bëhet me pesë. Meqenëse ke dhe kohën dy mujore.

**Erind Tosku** . Kisha një pyetje për Silvanën nga vëzhgimi që bëtë ishte ashtu siç mendoje apo ishte ndryshe?



**Silvana Aliu** . Atëherë duke qenë se unë i përmbahem asaj çfarë kam thënë që kam lënë detyra, pres të realizohen këto detyra dhe do flas pastaj. Se unë e kam thënë se gocat ishin dakord t'i zbatonin. Unë jam dakord por në momentin që gocat më thonë një dy tre që po më kërkoni ju ne do t'i bëjmë ...

**Enver Memolla** . Unë fola me Indritin plani i punës, afati kohor i dokumentacionit dhe shkojmë.

**Silvana Aliu** . Në rregull.

**Erind Tosku** . E di si i bie situatës se ishte drejtori i bujqësisë këtu dhe tha 4 muaj dhe unë nuk i di, ka tre vjet problematika dhe thotë tani po i shoh kjo nuk është justifikim. E kam në lidhje me drejtorat të gjithë kushdo që merr një post të ri në drejtori do marri përgjegjësinë dhe të atij që ka zëvendësuar ose mos e bëjë ose do i mbylli ai që ka qenë dhe ky i riu të fillojë nga zero ose do i mbarti dhe të mbajë përgjegjësi. Se kjo nuk është justifikim nuk di unë ca ka bërë ai, unë tani po filloj. Unë kështu e mendoj për çfarë thotë Silvana jam dakord.

**Rezart Vogli** . Puna është bërë sipas një standarti të miratuar nga Ministria ai është standarti që i referohen vajzat.

**Enver Memolla** . Më duhet informacion cili është afati kohor që keni vendosur për këtë hetim në Bashkinë Rrogozhinë? Çfarë plani keni, çfarë projektesh keni kërkuar dhe çfarë kërkoni, të kujt viti, muaji dhe cilat dosje? Sepse ndaj thashë dhe më parë me bisedën që kam bërë dhe me Indritin për të ngritur një komision duhet ngritur njëherë plani i punës nga komisioni vetë, çfarë afati kohor i keni lënë, 3 muaj? Afati kohor i hetimit të komisionit tuaj sa është? Se keni afat edhe ju se në bazë të përgjigjeve që do marrësh për tre mujorshin ti do dalësh në terren do verifikosh faktin dhe kjo të plotëson dosjen që thua ti. Por këtu duhet të shikosh çfarë programi ke çuar ti, çfarë kërkon ti realishtme shkrim? Prandaj po them komisioni kur ngrihet i çon me shkrim gjërat dhe thuhet nga data 1 Jana deri 31 Mars 2024 keni afat për të më nxjerrë dosjet filani, filani dhe unë me 14 Prill jam për të marrë dosjet në shqyrtim dhe këtu ti i dorëzon planin e punës dhe Bashkisë ndërkohë ke dhe planin tënd në komisionin e hetimit që është bërë unë kam ngritur nga 14 Janari dhe shkoj deri 14 Maj këtu mbyllet puna e komisionit dhe duhet të përcjellësh relacion në Këshillin Bashkiak përballë Bashkisë Rrogozhinë këtë duhet të bësh fillimisht që të mos kemi lojëra fjalësh ishte dosja nuk ishte dosja. Planin e punës siç po bëj unë me Indritin planin e bujqësisë ndaj e thirra drejtori sot që të merrja raportin ta lexoja ta dëgjoja të jepja këshilla do shkojmë dhe ne pastaj do bëjmë punën tonë në zyrë në terren dhe vijmë këtu pastaj.



**Mukades Gixhari** . Fjala për përgjegjësen e Shërbimit Social Xhensika Proshka.

**Xhensika Proshka** . Ne varemi pjesërisht nga Ministria, si për paketat që ne marrim si për kontrollet që na bëjnë.

**Enver Memolla** . Nuk e kisha fjalën për ty e kisha për grupin.

**Xhensika Proshka** . Për pjesën e dosjeve ne kemi një manual ku bazohemi , pra nuk i shpika as unë as drejtori është manuali unë ja vura në dispozicion dhe presorit dhe Silvanës komisionit pra këto kam këto më kërkohen. Sugjerimet ishin për më shumë foto dhe puna që bëhet tek fëmijët.

**Enver Memolla** . Ndjesë që po ju ndërpres prandaj thashë që duhet një plan pune nga komisioni sepse ti mund të kesh një punë tjetër në dorë dhe nuk e pret dot atë sot . Prandaj thashë duhet të çojmë plan t'i lejmë afatin kohor një, dy tre pesë muaj sa duhet dhe filan datë unë shkoj si komision dhe marr punët dhe dosjet e tyre në dorëzim vazhdoj përcjell faktin çfarë është aty dhe dal në terren për ta vërtetuar është fakt apo nuk është fakt. Dhe në fund të hetimit komisioni të raportojë të sjelli raportin ju sillni raportin dhe do ballafaqohen në këshill bashkiak në të mirë të komunitetit dhe në të mirën e punës tuaj dhe të këshillit bashkiak. Nuk e di në isha i qartë në këtë pjesë.

**Sokol Gosa** . Ne si komision prej tre anëtarë patëm planin e punës, qëllimi jonë ishte të verifikonim punën që kanë bërë vajzat , verifikimi i dosjeve materialet që disponojnë si dhe veprimtaria që kanë kryer gjatë kësaj periudhe. Kërkuam në fund fare progresin që ka bërë fëmija se mund të ketë dhe regres, materialet që kanë ardhur na bëhet qejfi që kanë ardhur materiale të vihen në dispozicion të qendrës sa më parë. Dhe në fund organizimin e aktiviteteve të jenë më të shumta të larmishme... këto ishin ato detyrat apo konkluzionet që arritëm ne si komision.

**Indrit Dedej** . Varesh nga ministria, ti paguhesh nga ministria apo nga ne? Kanë plan pune? Ato që nuk duan t'i ekspozojnë fëmijët mos marrin shërbim fare. Këtu e kemi ne të shohim sa evente bëni ju se për të kënaqur ato fëmijë bëhet kjo gjë. A kemi zyra në dispozicion? Se fundja fare nuk kemi pse mbajmë zyrën arsimorë aty kot pa paguar asnjë gjë i njerrim jashtë ato.

**Mitat Daja** . Është bërë mirë që u ngrit ky komision jo vetëm për këtë por një pjesë e mirë e sektorëve të bashkisë është detyra jonë apo ...duhet ta vejmë pak në punë bashkinë se duket vërtetë sikur është në gjumë dhe kjo nuk do të thotë që ka ndonjë tendencë... Duhet të kuptoni që po punoni me një grup fëmijësh që janë shumë në nevojë dhe duhet ta merrni shumë seriozisht



këtë punë , duhet ta ndjeni përgjegjësinë sikur jeni pjesëtarë. Ndoshya nëse dikush tjetër do tolerohet nga Bashkia që nuk e bën punën mirë ju duhet ta bëni më shumë se 100% punën sespe i tillë është grupi të tilla janë nevojat e këtyre njerëzve. Duhet të jeni në nivelin e duhur nëse ju duhet gjë nga bashkia nuk jua japin në mënyrë private kontaktoni dhe anëtarët e këshillit dhe e bëjmë kërkesën këtu nuk e dimë çfarë do realizohet por se ju ndihmojmë sepse këto janë njerëz me të vërtetë në nevojë. Zyra sociale duhet të jetë zyra më e preokopuar për këtë pjesë sepse merret me njerëzit që janë në nevojë ju keni grupin që merret me fëmijët dikush ka invalidët të shkosh isha diku në një shtëpi invalid ai me KEMP merrte 50 mijë lekë, çfarë mund të bëjë ai me 50 mijë lekë? E mora si shembull nuk do trajtoj me ju këtë problem merreni me prioritet nuk po gjykoj fare çfarë është bërë deri tani secili mban përgjegjësi dhe ne kemi përgjegjësi përveç para njerëzve kemi përgjegjësi edhe para Zotit. Përgjegjësitë janë ka prindër që nuk pranojnë ka prindër që duan ti bësh shumë temena këto janë vështirësitë e punës.

**Xhensika Proshka .** Nuk po flas vetëm për prindërit, po them që unë shkoj në një shtëpi unë nuk e di kush do hyjë kush do dalë në atë shtëpi unë rri aty 60 minuta , pra vështirësia më e madhe që vlerësohet tek ky shërbim është kjo që ne i shkojmë në shtëpi tjetrit.

**Erind Tosku .** Tani kjo është justifikim.

**Xhensika Proshka .** Nuk është justifikim është vështirësia e punës.

**Erind Tosku .** Vështirësia është se çdo punë ka vështirësi. Vështirësia është që në momentin që ti merr fëmijën si ta marrësh në qendër, si ta marrësh në shtëpi që në momentin që ti merr fëmijën me probleme fillon vështirësia ose që në mëngjes kur del nga shtëpia. Meqë qenka vështirësi mos shkojmë fare t'i bëjmë shërbimin atij djalit se kështu i bie. Nuk e mohojmë vështirësinë por nuk është argument ta marrësh si justifikim ...

**Xhensika Proshka .** Më fal unë nuk justifikova asgjë thjeshtë po flas për vështirësinë e punës tonë.

**Erind Tosku .** A ka kalendar për familjet që vëzhgohen...?

**Xhensika Proshka .** Po.

**Erind Tosku .** Për personat që nuk shkojnë merren masa?

**Xhensika Proshka .** Çfarë masash?





**Erind Tosku .** Po deshe shkon po të duash nuk shkon? Çfarë mase merret për grupin e punës që bën fizioterapinë? Shërbimi psikosocial që ka bashkia ndikon që prindi ta sjelli fëmijën. Ti thua se detyron por ti gjej mekanizma që prindit t'i mbushësh mendjen që ta sjelli. Unë i them këtë që për ekipin ka kalendar, ka masa unë këtë po them? Nuk po them të ndryshosh datën dhe orën e kalendarit por mos të shkojë fare ekipi tek fëmija një javë, dy javë 5 muaj se në 2023 që Silvana po thotë se tani po i biem mrapsh të gjithë gjërave unë them që ti nuk ke shkuar te x familje, tani çfarë mase është marrë për atë ekip po marr një shembull.

**Xhensika Proshka .** Nuk kemi patur raste që ekipi nuk ka shkuar në familje...

**Erind Tosku .** Mbaroi, ju jeni Bashkia më e mirë në botë.

**Enver Memolla .** Po zgjatemi kot, grup pune është ngritur nga Këshilli Bashkiak të ndiqen hapat.

**Erind Tosku .** Unë pyeta çfarë masash merren të tipit nuk po them asgjë do prindi nuk do prindi ta sjelli nuk po them këtë pyetje. Po them ka kalendar ? - Po. Qëllon që ka raste si po thotë drejtoresha që ndryshojnë nuk është në dispozicion dakord edhe këtu më pëlqen, ti si drejtori merr masa për ekipin që nuk shkon. Deri tani kemi punuar përkryer thotë... po shyqyr.

**Xhensika Proshka .** Duhet të kemi cedim të punës që të merren masa.

**Silvana Aliu .** Në periudhën Janar, Shkurt Mars çfarë keni bërë, kujt fëmije i keni shkuar?

**Xhensika Proshka .** Nëse do që nesër shkojmë tek familjet, ndërsa për punën janë dy qendra që do vazhdohet dhe për Rrogozhinën.

**Rezart Vogli .** Nuk besoj se keni marrë mundimin të shkoni tek qendra rinore dhe të shikoni...

**Erind Tosku .** Nuk kemi kohë...

**Rezart Vogli .** E ka komisioni...

**Erind Tosku .** Ti po përfshin gjithë Këshillin Bashkiak.

**Rezart Vogli .** Jo.



**Erind Tosku** . Komisioni të çohet të vijë ta shohi, cilësoje pak.

**Enver Memolla** . Pse i merrni me kaq stres kritikata?

**Xhensika Proshka** . Qendra është shumë e nevojshme ne e diskutuam në komision dhe me profesorin.

**Mukades Gixhari** . Faleminderit. Vazhdojmë me të ndryshme.

**Mitat Daja** . Nuk marrin pjesë as Kryetar, as nënkrytar, as drejtorat e bashkisë duhet t'i telefonojmë aman hajdeni drejtorat e bashkisë që të vijnë këtu. Unë sugjeroj që herë tjetër nëse ndodh kjo, ju bëni çfarë të doni por unë për vete do ta aplikoj kështu e kam ndarë mendjen. Në momentin kur këto të bashkisë nuk preferojnë që të vijnë që paguhen nga taksat e njerëzve , ne jemi të zgjedhur nga njerëzit se na quajnë kështu hajt se nuk prishin punë këta ne ta anullojmë mbledhjen e këshillit deri kur të vijnë ata të gjithë. Kur t'i mbushet mendja atyre të vijnë se do kenë dhe ato ndoshta n donjë gjë që duan ta kalojnë, e dyta ne sot kemi një problem që unë sot këtu doja që të ishte drejtori i urbanistikës, drejtorin e policisë bashkiake ose përgjegjësin. Ka drejtor policia bashkiake Bes? Po të vijë ta shihnim njëherë kush është. Thuaji mos lodhet shumë se është në fillimet e punës. Ti na jep dot përgjigje ne sot për një problem që kemi ne këtu?

**Mukades Gixhari** . Pika 9 të ndryshme Shqyrtim i informacionit dhe shprehjes së mendimit të ardhur nga Administratori i Njësisë Lekaj, mbi kërkesën e z. U. Bermeta banor i fshatit Zanbishë Njësia Administrative Lekaj për ndihmë financiare për shkak të dëmit të shkaktuar nga zjarri në fermën e tij.

**Enver Memolla** . Kryetare me leje të ndërhy pak? Në këtë rast duhet të jetë drejtori i emergjencave civile.

**Erind Tosku** . Këtë po diskutonim tani para se të flisje ti duhet ta lejmë për herën tjetër këtë se nuk kanë informacion dhe duhet të jetë drejtori i emergjencave civile. Emergjencat civile një dhe administratori i njësisë Lekaj, që ka qenë në terren aty verifikim fizik apo jo. Kështu që janë patjetër të dy që duhen patjetër, kështu që këtë e kalojmë për mbledhjen tjetër të këshillit bashkiak.

**Mukades Gixhari** . Atëherë e kalojmë për mbledhjen e radhës. Kemi projektvendimin për ndihmën financiare prej 50 mijë lekësh për z. Fatbardh Sokol. Po z. Rezart.



**Rezart Vogli** . Zotëria banon në shtëpi me bashkëshorten dhe dy fëmijët njëkohësisht që janë me zhvillim të prapambetur shtëpia në Mushnikë i është dëmtuar nga tërmeti dhe është në proces rindërtimi. Për arsye se jetojnë në kushte ekstreme jetese, shërbimi social i bashkisë Rrogozhinë në mbështetje të një donatori të zonës kanë bërë të mundur që familja të transferohet me shtëpi me qera në Rrogozhinë. Për arsye se vetëm një person në familje trajtohet me një pension minimal prej 10 mijë lekësh i drejtohem i këshillit bashkiak t’i ndihmojmë me një ndihmë prej 50 mijë lekësh.

**Enver Memolla** . Duke dëgjuar dhe kolegët, a marrin kujdestari këto? Ndërhyj sepse nuk është zgjidhje 50 mijë lekëshi, a ka mundësi të punojë?

**Alime Hoxha** . Bashkëshortja kujdeset për këto, kjo motra nëse i gjeni një vend pune...

**Silvana Aliu** . Jam dakord me çfarë tha Koli por pse duhet ta nxjerrim bashkinë sikur po ndihmon po vjen në ndihmë ka donatorë shumë bukur me aq sa kuptova nga sa the ajo është përfituese e ndërtimit të shtëpisë. Dhe aq sa kam lexuar apo thënë nga dikush punëtor i bashkisë është thënë që nuk do bëhen atje banesat se nuk kemi mjete që të çojmë pajisje. Tani me këto lekë që ka fituar nuk mund të marrin një shtëpi në qytet që dhe ne mos dalim donatorë mos dalim bamirës sikur po i ndihmojmë dhe njëkohësisht ato nuk paguajnë as qeranë. Jo vetëm apartament ka dhe banesa lart mos dalim sikur Bashkia duket me këtë 500 mijë lekësh po mbulon diçka tjetër . Është përfitues i tërmetit, e ka përfituar ku i kanë shkuar fondet? Ja jepni të blejë banesë të jetojë normal as dritat nuk i priten rrinë...

**Indrit Dedej** . Ideja është këtu që të bësh shtëpi atje ku nuk është për të bërë shtëpi dhe të lesh një familje që ka tetraplegjikë ky është krim që bën Bashkia.

**Rezart Vogli** . Pse është krim?

**Indrit Dedej** . Është krim se ti nuk e ke çarë kokën fare për ato familje ... nuk paska gjendje Bashkia të marrë një truall ...

**Silvana Aliu** . Ky 500 mijë lekëshi është për t’i mbyllur gojën.

**Indrit Dedej** . Nuk i bën gjë ky 500 mijë lekëshi edhe nga xhepi ti jap unë sot nuk i bën gjë... tani ku është Bashkia?!

**Silvana Aliu** . A është përfitues, a i ka marrë lekët, i gjeni një vend që të strehohen.



**Indrit Dedej .** Ka ndonjë zgjidhje Bashkia për këto familje? Nuk e ke ti fajin ka toka sa të duash jepi një truall ta ndërtojë ai shtëpinë, po u dogjën këto fonde.

**Sokol Gosa .** Do vijë rasti mbledhjen e radhës ama nëse jemi burra dhe zonja të nderuar siç janë këtu, të qëndrojmë një minutë këtu për një propozim kërkesë çfarë mund të ketë Edisoni këtu nuk votoj unë flas si Sokol Gosa. Janë tallur me ne një vit, me kë tallen ata me njerëz që janë të votuar nga populli. Edhe me rastin e familjes ka një vit diçka më pak a diçka më shumë një zgjidhje duhet të ishte marrë. Nuk ke faj ti por thashë do i hash ti, se të ishte ai llafosësia mirë me atë të gjatin, po tjerët që kanë përfituar nga dy tre herë fond tërmeti, po tjerët që kanë vila, çfarë bëhet kështu me këto familje si rasti i Land Bathës e tjera e tjera, çfarë bëhet me këtë bashki? Do dalin mos u mërzi shumë shpejt do vijë momenti, me letra si mund të fitosh si mund të japësh 30-40 milion nga 2-3 herë si mund të ndash ti familjet. Jemi dakord me 500 mijë lekëshin, ja them të gjithë këshilltarëve jo vetëm për këto familje por dhe për familje të tjera edhe për atë projektin që ishte Xhesi këtu e keni mbështetjen tonë ama jo të na trajtoni në këtë formë kurrën e kurrës, po do vijë dhe ajo Zoti është i madh.

**Indrit Dedej .** Unë nuk e di por i propozoj kolegëve që të japim 200 mijë lekë të reja ta përballojë sepse kjo është qesharake 500 mijë lekësh këtu çfarë të lajë më para ai të lajë drita ujë apo borxhet në dyqane ka nevojë për ilaçe. Jepni një 200 mijë lekësh aty dhe ndoshta i bën punë për momentin derisa të bëjë një zgjidhje Bashkia.

**Enver Memolla .** Çfarë kisha për të thënë e thashë por dhe kolegët kanë të drejtë. Në emër të grupit të PS duhet të kërkohet nga kryetari i bashkisë prezenca e administratës realisht është turp, kur them është turp është turp. Nëse e sjell në rend dite zbatime deri në fund edhe unë kam punë e kam mbyllur zyrënjam këtu prej tre orësh. Është e disata herë që e them unë edhe mund të bojkotoj vi njëherë në 6 muaj por jam i zgjedhur nuk jam i emëruar kam dhe unë detyrimin tim moral e politik por ama është turp. Na ka ngelur Rezi laj e thaj Rezin, çfarë do bëjë Rezi vetëm, nuk është diçka që lindi biseda e ke të përcaktuar në rend dite ke kërkuar dhe mbledhjen e komisioneve dhe administrata nuk vjen është orar pune ky nuk është me të ftuar me ftesë është orar pune. Nëse këto marrin këshillin bashkiak për punë do kenë probleme realisht, unë përfaqësoj maxhorancën këtu por ama nga ana njerëzore bie dakord me kolegët herë e disatë që e them, kjo pjesë për mua në emër të grupit të PS çoj notë proteste administratës së Bashkisë Rrogozhinë ose të marrin masa ose t'i bëjnë vetë vendimet atje brenda. Sepse nuk kalon vendimi në këshill bashkiak nuk e kalon këshilli... këshilli po kërkon dy gjëra minimale thjeshtë vendin e punës asgjë më shumë, hajdeni në vendin e punës. Nuk ka ardhur ky projektvendim sot për nesër ka pesë ditë që ka ardhur në Këshill.



**Erind Tosku** . Vero po të ndërpres ne e kemi fajin vetë që po e nisim mbledhjen ...

**Enver Memolla** . Duhet të kishim ikur.

**Erind Tosku** . E di ti Rez sa herë i ka marrë Visi në telefon drejtorët dhe nuk vijnë tani nuk është argument që do me dalë mbrojtësi i të tjerëve.

**Enver Memolla** . Rezi drejtorja nuk ka një punëtorë ka 6 ka 7 nuk po të kërkoj drejtorin më sill një përfaësues të sektorit në Këshillin Bashkiak. Më fal drejtorja jotë sa staf ka? Tetë, kur nuk je ti nuk do vijë asnjë? Unë kërkoj personin që ka bërë projektvendimin. Me këtë vendim çfarë do bëjmë? Do e hedhësh në votim?

**Mukades Gixhari** . Jeni dakord për ndihmën? Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 16 vota pro, projektvendimiv me shkresë Nr.1199.Prot datë 26.03.2024 “Për miratimin e kërkesës me efekt financiar prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për familjen e z. Fatbardh Shefqet Sokoli”.*

**Vendim nr.15.** Miratohet me 16-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1199.Prot datë 26.03.2024 “Për miratimin e kërkesës me efekt financiar prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për familjen e z. Fatbardh Shefqet Sokoli”.

**Erind Tosku** . Meqë kemi policinë bashkiake këtu të mbarojmë me këtë dhe dalim tek të ndryshmet.

**Mitat Daja** . Atëherë është problemi për një konflikt për tetë familje që kanë atje në lagje na kanë kontaktuar këto familje jo vetëm mua por shumë prej anëtarëve të këshillit, kanë sjellë një dokument kanë bërë një kërkesë tek ish lagjja “Çetë”, lagjja nr.1. Kanë konflikt me Misir Gjinin që pretendon që ka marrë certifikatë pronësie, ai ka të drejtën e vet por dhe këto kanë të drejtën e vet. Në fakt për shumë vite rruga ka qenë e hapur dhe e përdorshme jemi 8 familje që kalojmë në atë rrugë. Megjithatë ditet e fundit është bërë bllokimi i rrugës se pretendon certifikatë pronësie. Dhe ne si banorë si lagje jemi shqetësuar për aksesin në këtë rrugë, ku kjo ka qenë dhe është rruga kryesore për të dalë dhe hyrë në lagje. Madje familjari Petrit Gjini është i paralizuar dhe ka nevojë për kujdes shëndetësor ku bllokimi i rrugës bllokoi dhe ambulancën. Sipas banorëve kjo rrugë është hapur me vendim gjykate që nga viti 1992, pra ka një vendim gjykate dhe ka një procesverbal që është mbajtur këtu, vendimin e gjykatës nuk e kanë sjellë. Dhe është bërë një procesverbal nga bashkia e asaj kohe ku urbanist ka qenë Arif Daja. Me këtë kërkesë i bëjmë



thirrje bashkisë që të ndërhyjë dhe të marrë masat e nevojshme dhe firmat e këtyre personave. Si do zgjidhet puna e këtyre?

**Enver Memolla** . Unë jam kontaktuar personalisht nga djali i Petrit Gjinit por unë di që ky është një proces i mbartur ndër vite por sidomos në moment që filloi dhe rruga lart që është bërë e re. Toka që ky ka, ka qenë në projekt do preket nga rruga apo jo? Sepse më duket se ka detyrime Bashkia, apo jo Rez...? Misir Gjini ka...? Bëhet fjalë lart apo poshtë? Ajo lart tani unë di që ka pasur konflikt ka qenë dhe policia bashkiake, çfarë është konstatuar?

**Besnik Tosku** . Atëherë ne kemi qenë dy herë atje dhe atje duhet një komision, ai ka tapi për atë rrugë, ajo rrugë ka qenë rrugë këmbësorësh e cila u hapte fshtresh atëherë dhe ngeli. Në moment të caktuar ky ka një tapi edhe thotë që është prona ime, tani bashkia ka negociuar disa herë që në atë rrugë meqenëse është problemi i pagesës...

**Enver Memolla** . Kjo është marrëveshje pa letra?

**Besnik Tosku** . Marrëveshje pa letra sepse ai nuk pranon se ai thotë po nuk u likuidua kjo pjesë këtu nuk negocion.

**Enver Memolla** . Atëherë ai është në të drejtën e tij ka pronën e tij, certifikatën e të gjitha. Pyetja që lind është çfarë mase ka marrë bashkia për këto 8 familje.

**Mitat Daja** . Çfarë do i bëni ju do vriten ato.

**Besnik Tosku** . Ne s'kemi çfarë i bëjmë ato duhet t'i drejtohen gjyqit në fund...

**Enver Memolla** . Tani Bashkia ka të drejtë të ja shpronësojë tokën?

**Besnik Tosku** . Me vendim e shpronëson të këshillit Bashkiak.

**Enver Memolla** . Nga urbanistika a ka shkuar dikush të ja bëjë një plan rievimi sa është ajo rrugë sa tokë i merr dhe sa kosto ka? Sepse mesa di unë mbi stacionin e treniot është 4200 apo 4100 lekë m<sup>2</sup> .

**Besnik Tosku** . Ai thotë që po nuk më likuiduat tek kjo pjesë këtu unë nuk negocioj.

**Enver Memolla** . Në projektet publike bashkia ta shpronëson tokën dhe atje lart.



**Besnik Tosku** . Po për hapjen e hapësirave publike shkolla rruga është e padiskutueshme.

**Erind Tosku** . Mesa shoh unë Bashkia nuk ka marrë asnjë masë, ju keni shkuar keni bërë detyrën tuaj si polici bashkiake rregullatorët e bashkisë asnjë nuk e ka vënë ujin në zjarr që drejtori i urbanistikës juridiku, pjesa e shërbimit psikosocial që njerëzit mos të konfliktohen.

**Besnik Tosku** . Atëherë policia bashkiake nuk është vendimmarrëse është strukturë e bashkisë ne asnjëherë nuk punojmë në mënyrë të pavarur, ne atje e vendos zyra e urbanistikës, ajo vendos më jep urdhërin dhe unë e ekzekutoj. Unë kam mbështetur punonjësit e bashkisë kam qenë prezent mbështes zyrën e urbanistikës inxhinierin, agronomin kur tha Veri ky është një problem i mbartur. Nuk është problemi që lindi sot.

**Indrit Dedej** . 30 vjet kam kaluar unë në atë rrugë,

**Altin Tosku** . Jam rritur unë aty.

**Indrit Dedej** . Bashkia është e detyrura që këtyre banorëve t'i gjejë zgjidhje.

**Enver Memolla** . Ka diçka tani se konfliktet nuk bëhen nga qejfi bëhen nga halli, tani ky konflikt është dhe për tokën poshtë dhe këtej lart siç tha dhe Indriti por ky konflikt ka vite dhe dy herë ka qenë policia bashkiake. Sa bën ai fond sa tokë do i merrni ju atij për ta bërë një projekt për atë rrugë, si ka mundësi se janë 8 banorë është konflikt kur do merret zgjidhja kur të bëhet hata, larg qoftë o Zot. Se është e disata herë tani po më shkruan Rusta kam babin të paralizuar me karrocë thotë nga ta nxjerr ta fluturoj mesa di unë bëhet fjalë 45 m të gjatë, 45 x 4 = 160 m x 4600 lekë bëji ti llogaritë. Ai nuk po ta kërkon si truall e do shpronësim kaq.

**Besnik Tosku** . Atë e ka thirrur policia e të gjithë.

**Enver Memolla** . Ai mund të jetë i vështirë për të negociuar por është në të drejtën e tij. Ai nuk ka tokë shtet ai ka tokën e vet këtu. Një sugjerim kam unë nuk dua që kjo pjesë të rrijë këtu dhe të flejë gjumë në sirtar, në mbledhjen e ardhshme personat përgjegjës o ti kenë dhënë zgjidhjen a të vijne t'i japin zgjidhje është konflikt për 9 familje është konflikt nuk është dasëm.

**Mukades Gixhari** . Ndonjë diskutim tjetër?

**Saimir Cani** . Për kryetarin e fshatit Zanbishë njerëzit nuk janë dakord me atë që është emëruar kërkojnë zgjedhje.



**Enver Memolla** . Kryeplaku nuk është vendosur akoma sapo fola.

**Mukades Gixhari** . Nuk janë bërë zgjedhje akoma në Lekaj.

**Erind Tosku** . Policët bashkiakë që kemi ne vetëm në mëngjes që rrijnë tek Çerdhja dhe tek Kopshtet e shkollat janë me detyrë apo kanë dhe detyra tjera.

**Besnik Tosku** . Ai që rri tek çerdhja është i detyruar të rri nga ora 7 deri në orën 8;30 - 09.00 pas asaj ai ka detyrë të patrollojë tek tregu parku.

**Erind Tosku** . Hapësirat publike keni evidentuar që janë zënë dhe a keni marrë masa?

**Besnik Tosku** . Aktualisht unë kam qenë aty dhe me këtë efektiv që kam ka qenë e pamundur të verifikoj, kemi qenë të cinguar në numër. Vetëm për të kontrolluar plazhin që fillon nga fundi Majit deri në fund të Shtatorit mbi 6km vijë lineare. Janë hapur shpallje për efektivë kanë bërë ca kërklesa disa të rinj do merren në testim në provim.

**Erind Tosku** . Sa është numri që policia bashkiake të plotësohet?

**Besnik Tosku** . 25.

**Erind Tosku** . Disa gjëra që janë më të rëndësishme se qeset janë pa i hyrë profesionit.

**Besnik Tosku** . Unë ta thashë që policia bashkiake mbështet bashkinë, të gjithë drejtoritë e bashkisë ne i mbështesim ne nuk jemki vendimarrës ne jemim vendimarrës në qoftë se është prishur rruga trotuaret hapësirat publike i kemi ne policia bashkiake. Në qoftë se marr njoftim nga drejtoria përkatëse që Indritit ka vendosur dy tavolina jashtë dhe ky paguan taksa pranë bashkisë unë nuk kam të drejtë... në qoftë se ky personi nuk i paguan... Është i vetmi qytet Rrogozhina që ka më pak zënie të hapësirave publike, është qyteti që ka është më i pastër në të gjithë zonën.

**Erind Tosku** . Nëse ti thua më sjell urbanistika... nëse nuk sjell ti nuk shkon. Kështu i bie nëse ty nuk të sjellin një problekatikë ti nuk vepron, kështu i bie.

**Besnik Tosku** . Jo nuk më kuptove fare. Unë zënien e hapësirave publike e kam detyrë, funksioni i policisë bashkiake është siguria.





**Erind Tosku** . Ti nuk e di kush i ka zënë hapësirat publike apo jo? Ty të vjen nga urbanistika nga ankesat e qytetarëve.

**Besnik Tosku** . E ngatërrove, unë polici çdo ditë më raporton për hapësirat publike edhe për tregun dhe çdo gjë po të doni jua ve ndë dispozicion çfarë më ka raportuar tani. Unë kujtova se ju më kuptuat por nuk më paskeni kuptuar.

**Erind Tosku** . Nuk po kupton ti atë që po them unë.

**Besnik Tosku** . Ti po thua ti nuk ke kontrolluar se nuk të ka sjellë listën ai?!

**Erind Tosku** . Po.

**Besnik Tosku** . Jo, ne tani fillojmë verifikimin e zënies së hapësirave publike. Shkojmë ka vënë dy tavolina paguan detyrimet për ato unë nuk kam të drejtë të ja heq.

**Erind Tosku** . Dakord se këtë e kuptoj unë, nuk vepron dot me mëndjen tënde.

**Besnik Tosku** . Po normal. Nuk është marrë aktualisht asnjë polic në organikë për arsye sepse nuk ka pasur kërkesa të mjaftueshme, që do bëhne kërkesa do merret trajnimi do bëhet provimi do titullohen, tek burimet njerëzore jo unë.

**Silvana Aliu** . Para shkollës bllokohet rruga.

**Besnik Tosku** . Me çfarë ?

**Silvana Aliu** . Me makina.

**Besnik Tosku** . Atje parkojnë më shumë mësuesit.

**Silvana Aliu** . Nuk ka mësues jeni ju të bashkisë.

**Besnik Tosku** . Ajo rrugë në fillim janë parkingjet e furgonave, ato furgonat përderisa paguajnë licensën duhet gtë kenë vendin e parkimit, janë deri tek pjesa afër bashkisë.

**Erind Tosku** . Janë të zëna nga mjetet.

**Besnik Tosku** . Jo.



**Erind Tosku** . Nuk kam jetuar në Rrogozhinë unë ?!

**Besnik Tosku** . Nuk është zënë asnjëherë.

**Alime Hoxha** . Unë kisha diçka për zënien e hapësirave publike, janë zënë jo vetëm trotuaret por po na dalin dhe në rrugë edhe pjesën e rrugës e zenë. Tani këtu duhet bërë pak punë tek policia bashkiake se ne kalojmë përditë në trotuare përplasemi kemi tavolina edhe nga ana lokalit por na zenë edhe rrugët që janë për të kaluar mes lulishtes edhe aty janë vënë tavolina.

**Besnik Tosku** . Është e vërtetë që është detyra e policisë bashkiake nuk shmanget hapja e hapësirave publike është e jona.

**Alime Hoxha** . Përveç trotuareve po zihet edhe rruga jo me vazo lulesh... edhe tek parkimet para gjimnazit ajo pjesa e parkimeve unë nuk e di...

**Besnik Tosku** . Atëherë deri tek bashkia janë me pagesë...

**Alime Hoxha** . Pas bashkisë.

**Besnik Tosku** . Nga bashkia që është poshtë është pa pagesë.

**Alime Hoxha** . Është pa pagesë por ajo zihet nga një person aty 4 makina dhe nuk ka vend për të parkuar njeri.

**Besnik Tosku** . Nuk e di tani nuk e kam verifikuar.

**Altin Tosku** . Nëse një biznes vendos një karrike para tij duhet të paguajë, duhet të vijë bashkia të vejë vizën ta marrin me pagesë privat jo duke vënë arka duke vënë karrike.

**Enver Memolla** . Pjesa e parkimit realisht është pak problem për shumë arsye qoftë dhe nga policia bashkiake, qoftë dhe nga policia e rendit. E them këtë jo pa shkak sepse gjobiten në parkime të palejuara me të drejtë një makinë, tre nuk gjobiten. Ndodh dhe gjëja tjetër Altini ka vetë biznes, biznesi paguan deri tek cepi i trotuarit ndërkohë që ze trotuarin ze dhe parkimin dhe të ardhurat e bashkisë zero. Kohët e fundit është kthyer shqetësim tek bashkia e re godina e re edhe për pjesën e bizneseve që janë aty. Një punonjës bashkie e fut makinën në 8 pa 5 dhe e heq në 4 e gjysëm. Dhe qytetarët që do marrin shërbim aty e lejnë makinën tek fusha e sportit ose këtu mbrapa dhe unë sugjeroj që ajo pjesë aty mos jetë fare në shërbim të administratës, të ishte



në shërbim të qytetarit biznese që ndalojnë aty për të marrë shërbim në bashki. Dhe pjesa tjetër dhe për pallatin pas është bërë problem, rezidentët nuk parkojnë dot më aty se vijnë punonjësit e bashkisë që në mëgjës aty.

**Erind Tosku .** Nuk hyn do të në çerdhe Veri... se unë i rashë gjatë e gjatë Besit por tani më vjen keq, në çerdhe fusin tre makina aty dhe bllokojnë polici bashkiak është aty zyra e policit bashkiak është aty, e shikojnë që rruga e lagjes është e bllokuar , të bllokosh rrugën e lagjes dhe rrimë të gjithë kot aty.

**Enver Memolla .** Unë po them dhe për banorët që janë rezidentë po i zihen atyre parkingjet se vijnë punonjësit e bashkisë, më kanë thënë çfarë bëni kështu. Tek pjesa e bashkisë janë tre parkingje të vizuara do bëhet dhe i katërti. Kam një pyetje të drejtpërdrejtë aty ka një gabim të madh, aty duhet të jetë një parkim me shenjën e invalidëve se ka invalidë që duan të marrin shërbim.

**Besnik Tosku .** Ku ta ketë?

**Enver Memolla .** Para Bashkisë, derisa ke rampën aty tek shkallët duhet ta kesh dhe aty.

**Lulzim Hasa .** Mbi tavolinë ke një propozim të disa këshilltarëve, në respekt të këtyre ta shqyrtojmë tani.

**Enver Memolla .** Po do shkojë tek komisioni ai.

**Mukades Gixhari .** “Propozim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Rrogozhinës z. Ramazan Aliu. Në mbësheshtetje të nenit 54 gërma “m”, të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të nenit 15, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr.10/2015 datë 19.02.2015. Propozojmë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Rrogozhinës z. Ramazan Gani Aliu me rastin e daljen në pension me motivacionin : “Për kontributin e vyer dhënë për komunitetin dhe Bashkinë Rrogozhinë si nëpunës i administratës së bashkisë për rreth 35 vite, ku ka punuar me përkushtim, ndershmëri dhe profesionalizëm”.

**Enver Memolla .** Kaloja komisionit.

**Lulzim Hasa .** Ne i propozojmë komisionit, ato vendosin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Erind Tosku** . Të shihen kriteret.

**Sokol Gosa** . Kriteret sa kontribuar për komunitetin, çfarë veprash ka bërë.

**Mukades Gixhari** . Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

**MBYLLET MBLEDHJA**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 30<sup>00</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 2 orë ; 16 min ; 00 sek.

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 28 (njëzet e tetë).

**Miratohet procesverbali :**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**

**Sekretari i Këshillit**

**Ervis Shera**